

Treguesi i lëndës

I. BAZA LIGJORE:

Detyrimi për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private të subjektit kandidat për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë dhe personave të lidhur me të, bazohet në ligjet:

1. Ligji nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar me ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, me ligjin nr. 9475, datë 9.2.2006, me ligjin nr. 9529 datë 11.5.2006, ligjin nr. 85/2012 datë 18.9.2012, ligjin nr. 45/2014 datë 24.4.2014 dhe ligjin nr. 42/2017 datë 6.4.2017.
2. Ligji nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar me ligjin nr. 9475, datë 9.2.2006, me ligjin nr. 9529, datë 11.5.2006, me ligjin nr. 9690 datë 5.3.2007, me ligjin nr. 86/2012 datë 18.9.2012 dhe me ligjin nr. 44/2014 datë 24.4.2014.
3. Ligji nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar;
4. Ligji nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar;
5. Ligji nr. 76/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
6. Ligji nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”;
7. Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
8. Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

II. DEKLAROJNË PASURITË DHE INTERESAT PRIVATE, SUBJEKTET SI VIJON:

Dokument i zyrtar “**Deklaratë e pasurisë dhe interesave private të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë**”, miratuar me Urdhër nr. 284, datë 9.5.2017 të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI dhe botuar në Fletoren Zyrtare nr. 104 datë 10.5.2017, plotësohet nga kandidatët e përcaktuar në nenin 3/1 të ligjit nr. 9049 datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar:

1. Mbartin detyrimin për deklarimin e pasurisë dhe të interesave private:

a) kandidatët që shprehin interesin për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese, sipas parashikimeve të legjislacionit, që rregullon qeverisjen e sistemit të drejtësisë;

b) kandidatët që shprehin interesin për Inspektor të Lartë të Drejtësisë, si dhe kandidatët jomagjistratë për pozicionin e inspektorit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sipas parashikimeve të legjislacionit që rregullon qeverisjen e sistemit të drejtësisë;

c) kandidatët për praninë në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, si dhe i diplomuari që kandidon për t'u emëruar magjistrat, sipas parashikimeve të legjislacionit që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve;

ç) kandidatët për gjyqtarë dhe nëpunës civilë gjyqësorë në gjykatat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, si dhe familjarët e afërm të tyre, sipas parashikimeve të legjislacionit që rregullon organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar;

d) kandidatët për prokuror, oficer hetimi, personel administrativ i Prokurorisë së Posaçme, Byrosë Kombëtare të Hetimit, si dhe familjarët e afërm të tyre, sipas parashikimeve të legjislacionit që rregullon organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar;

dh) kandidatët, të cilët, sipas parashikimeve të legjislacionit që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, kërkojnë ngritje në detyrë në shkallë më të larta ose të specializuara;

e) kandidatët për anëtarë të Gjykatës së Lartë nga radhët e juristëve të spikatur, sipas parashikimeve të legjislacionit që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve;

ë) kandidatët për kryetarë të gjykatës ose prokurorive të tjera, sipas parashikimeve të legjislacionit që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve;

f) çdo person tjetër që ka detyrimin të deklarojë para kandidimit, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Kandidatët për pozicionet e përmendura në pikën 1, të këtij neni, që janë subjekte që mbartin detyrimin për deklarimin e interesave privatë, sipas parashikimeve të nenit 3, të këtij ligji, i nënshtrohen kontrollit të plotë të pasurisë. Nëse gjatë 180 ditëve para paraqitjes së kërkesës, kandidati është kontrolluar nga Inspektorati i Lartë i Kontrollit dhe Deklarimit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe kontrolli nuk ka rezultuar në disfavor të tij, atëherë kontrolli konsiderohet i kryer.

3. Inspektorati i Lartë kryen kontrollin e plotë për verifikimin e vërtetësisë dhe të saktësisë së të dhënave që përmbahen në deklaratën e personave të përmendur në pikën 1 të këtij neni, brenda 2 muajve nga paraqitja e deklaratës, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj. Në përfundim të verifikimit, Inspektori i Përgjithshëm u dërgon menjëherë institucioneve përkatëse raportin e verifikimit.

III. OBJEKTI I DEKLARIMIT TË PASURIVE DHE INTERESAVE PRIVATE:

Bazuar në nenin 4 të ligjit nr. 9049 datë 10.4.2003 *“Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”*, i ndryshuar, deklarimi përfshin interesat private të kandidatit/ subjekt deklarues, të bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es dhe fëmijëve në moshë madhore, si dhe burimet e krijimit të tyre deri në datën e dorëzimit të deklaratës së interesave private si vijon:

- a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil;
- b) pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publikë, dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil;
- c) sendet me vlerë të veçantë mbi 300 000 (treqind mijë) lekë;
- ç) vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim;
- d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në cash jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj;

- dh) detyrimet financiare ndaj personave juridik dhe fizik, të shprehura në lekë ose në valutë të huaj;
- e) të ardhurat personale për vitin, nga paga ose pjesëmarrja në borde, komisione ose çdo veprimtari tjetër që sjell të ardhura personale;
- ë) licencat dhe patentat që sjellin të ardhura;
- f) dhuratat dhe trajtimet preferenciale, përfshirë identitetin e personit fizik ose juridik, prej nga vijnë apo krijohen dhuratat a trajtimet preferenciale. Nuk deklarohen dhurata ose trajtime preferenciale kur vlera e tyre është më e vogël se 10 000 (dhjetë mijë) lekë, si dhe kur dy e më shumë dhurata ose trajtime preferenciale, të dhëna nga i njëjti person, së bashku, nuk e kalojnë këtë vlerë, gjatë së njëjtës periudhë deklarimi;
- g) angazhime në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie që krijon të ardhura, përfshirë çdo lloj të ardhure, të krijuar nga kjo veprimtari ose ky angazhim;
- gj) interesa privatë të subjektit, që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga marrëdhëniet familjare apo të bashkëjetesës;
- h) çdo shpenzim i deklarueshëm, me vlerë mbi 300 000 (treqind mijë) lekë, i kryer gjatë vitit të deklarimit.

IV. KUJTESË PËR MËNYRËN E PLOTËSIMIT TË DEKLARATËS SË PASURISË DHE INTERESAVE PRIVATE.

A) Deklarata e pasurisë dhe interesave private e kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë.

1. Dokumenti zyrtar **“Deklaratë e pasurisë dhe interesave private e kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë”**, të plotësohet nga kandidatët e përcaktuar në nenin 3/1 të ligjit nr. 9049 datë 10.4.2003 *“Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”*, i ndryshuar.
2. Formulari i deklarimit të interesave private, plotësohet në mënyrë elektronike, por në çdo rast nënshkruhet me shkrim.
3. Bazuar në nenin 4 të ligjit nr. 9049 datë 10.4.2003 *“Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”*, i ndryshuar, deklarimi përfshin interesat private të kandidatit/subjektit deklarues, të bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es dhe fëmijëve në moshë madhore, si dhe burimet e krijimit të tyre.
 - Të deklarohen të gjitha pasuritë e akumuluar ndë vite, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë dhe të drejtat real mbi to sipas Kodit Civil nga kandidati/subjekt deklarues dhe/ose në bashkëpronësi me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en dhe fëmijët madhorë deri në datën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë dhe interesave private. Në çdo rast duhet të deklarohen në mënyrë analitike burimet e krijimit për çdo aset. Duhet të mbahet në vëmendje fakti që deklarohet vlera e blerjes apo e shpenzimeve të kryera dhe jo vlera e tregut për periudhën e deklarimit (faqe 3 e deklaratës.)
 - Të deklarohen të ardhurat nga angazhime në veprimtari private dhe/ose publike deri në datën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë dhe interesave private.
Të përcaktohet qartë institucioni ku ka qënë apo është i punësuar personi i lidhur (bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja dhe fëmijët në moshë madhore) i subjektit apo aktiviteti që ka ushtruar apo ushtron (fq.4 e deklaratës).
 - Në rastin e kredive bankare, të deklarohet vetëm gjendja e kredisë në datën e fillimit të detyrës dhe jo gjendja e kredisë + interesa të llogaritura. (fq.5 e deklaratës).
 - Kur deklarohen likuiditetet, duhet të shënohet banka në të cilën janë kryer veprimet.
 - Do të deklarohet çdo send me vlerë të veçantë mbi 300.000 lekë si piktura, orë dore apo orë tavoline, suvenire, paisje të ndryshme dhe çdo send tjetër që nuk regjistrohet në regjistrat publikë.
4. Data e dorëzimit, e shënuar në faqen nr. 1 të deklaratës së interesave private, duhet të përputhet më gjendjen e të dhënave të deklaruara në faqet e tjera të deklaratës së pasurisë dhe interesave private.

5. Kur pasuria e personave të lidhur, bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es dhe fëmijëve në moshë madhore është e ndarë dhe e regjistruar si e tillë në organet e administratës shtetërore ose gjyqësore, deklarimi paraqitet veçmas nga çdo person i lidhur me pasuri të regjistruar veçmas dhe i bashkëlidhet deklaratës së subjektit që ka detyrimin për deklarim. Pasuria është e detyrueshme për deklarim edhe në rastet kur është e paregjistruar në regjistrat publikë dhe privatë.
6. Subjekti - kandidat për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë nuk legjitimohet të nënshkruajë deklaratën e interesave private të personave të lidhur.

B) Deklarimi i pasurisë dhe interesave private nga personi i lidhur me kandidatin për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë.

1. Dokumenti zyrtar "*Deklarata e pasurisë dhe interesave private e personit të lidhur*" duhet të plotësohet nga personat e lidhur (bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja dhe fëmijët në moshë madhore), të cilët mbartin detyrimin për deklarim në bazë të nenit 21 dhe 22 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, për pasuritë që disponojnë veçmas.
2. Personi i lidhur me kandidatin për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë, (*bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët në moshë madhore*), i cili mbart detyrimin për deklarim të interesave private në Inspektoratin e Lartë, plotëson formularin përkatës nga faqja 7-10.
3. Personi i lidhur me kandidatin *me lidhje gjaku apo martesë, i cili banon më shumë se 120 ditë në vit në të njëjtin vendbanim* plotëson formularin përkatës nga faqja 11-14. Ky formular plotësohet vetëm nga personat e lidhur me kandidatët që shprehin interesa për:
 - a. gjyqtarë dhe nëpunës civilë gjyqësorë në gjykatat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar,
 - b. prokurorë, oficerë hetimi, personel administrativ i Prokurorisë së Posaçme, Byrosë Kombëtare të Hetimit.

Në çdo rast, personi i lidhur është i detyruar të plotësojë faqen e parë të deklaratës, **AUTORIZIMI**, ku deklaron nëse ka ose jo pasuri të regjistruara në emrin e tij. Formulari i plotë do të plotësohet vetëm në rastet kur personi i lidhur ka pasuri të regjistruar veçmas.

Kujdes: Të gjithë kandidatët për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë dhe personat e lidhur me ta (bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja dhe fëmijët në moshë madhore, si dhe personat e lidhur nga gjaku dhe martesë, me të cilin banon më shumë se 120 ditë në vit në të njëjtin vendbanim), nuk mund të mbajnë dhe të deklarojnë gjendje në Cash jashtë sistemit bankar mbi shumën 1,5 (një presje pesë) milion lekë. Depozitimi në institucionet bankare i gjendjeve Cash mbi vlerën 1,5 milion lekë është i detyrueshëm përpara dorëzimit të deklaratës së interesave private në ILDKPKI.

Bashkëlidhur subjekti deklaruës duhet të dorëzojë fotokopje të letërnjoftimit (kartës së identitetit) për vete, bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore, si edhe e çdo personi tjetër, sipas çertifikatës familjare. Në mungesë të letërnjoftimit, të dorëzohet fotokopje e pasaportës ose çertifikatë personale e subjektit dhe e personave të lidhur.

Nga kandidatët që shprehin interes për:

- a. gjyqtarë dhe nëpunës civilë gjyqësorë në gjykatat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar,
- b. prokurorë, oficerë hetimi, personel administrativ i Prokurorisë së Posaçme, Byrosë Kombëtare të Hetimit;

të dorëzohet letërnjoftim (kartë identiteti) ose fotokopje e pasaportës ose çertifikatës personale për çdo person të lidhur nga gjaku apo martesë, i cili banon më shumë se 120 ditë në vit në të njëjtin vendbanim me subjektin deklaruës.

Mosplotësimi i këtij detyrimi, passjell mospranimin e deklaratës së interesave nga ILDKPKI.

Subjekti deklarues dhe personat e lidhur me të, duhet t'a shoqërojnë deklaratën e pasurisë dhe të interesave private me të gjithë dokumentat justifikues/shoqëruese të nevojshme për të provuar vërtetësinë e deklarimeve në sasi dhe në vlerë, për ligjshmërinë dhe burimin e krijimit të interesave private (të pasurive, të detyrimeve financiare, të të ardhurave).

Bashkëlidhur modeli i inventarit të dokumentacionit justifikues/shoqërues të deklaratës së pasurisë.

Nëse keni persona të lidhur nga gjaku apo martesë, që banojnë me ju më shumë se 120 ditë në vit, në të njëjtin vendbanim, duhet të plotësojnë deklaratën e interesave private me nr.faqe 11-14 të këtij formulari.

Në pikën 1, 2 dhe 4 të nenit 4/2 të ligjit nr. 9049 datë 10.4.2003 "*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë*", i ndryshuar, përcaktohet se:

Subjektet, të cilat nuk janë zyrtarë në momentin e dorëzimit të deklaratës, e dorëzojnë atë pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, sipas përcaktimeve të këtij neni, përveç kur parashikohet ndryshe në ligj.

***Kujdes:* Të gjitha faqet e formularit të deklarimit duhet të nënshkruhen (përkatësisht) nga deklaruesi dhe personat e lidhur me të, në të kundërt deklarata do të kthehet dhe do të konsiderohet e padorëzuar në Inspektoratin e Lartë.**

V. SANKSIONET:

1. Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara në ligj, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë sipas nenit 40 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 "*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë*", i ndryshuar.
2. Refuzimi për deklarim, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive dhe interesave private përbën vepër penale dhe dënohet sipas nenit 257/a të Kodit Penal.
3. Për informacione të mëtejshme, kontaktoni në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave me Seksionin e Marrëdhënieve me Autoritetet Përgjegjëse në numrat e telefonit **042 259 461**, Free.08009999, info@hidaa.gov.al.
4. Të dhënat e deklaratës lejohet të publikohen sipas ligjit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE
DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE

Adresa: Rr.Reshit Çollaku, Tel: 0800 9999, Website: www.hidaa.gov.al, E-mail: info@hidaa.gov.al

Nr. Indeksi në ILDKPKI dhe Viti	

DEKLARATË E PASURISË
DHE INTERESAVE PRIVATE

E kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë

Plotësohet nga kandidati që shpreh interes për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë, i cili mbart detyrimin për deklarimin e pasurisë dhe të interesave private të tij, të bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es dhe të fëmijëve madhorë, në bazë të nenit 3/1 të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar dhe Ligjit nr. 9367, dt.7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

A U T O R I Z I M
PËR KONTROLLIN E DEKLARATËS SË PASURISË DHE INTERESAVE PRIVATE

Emri

ALTIN

Atësia

JANI

Mbiemri

PANO

Kandidat për

Prokuror në Byronë Kombëtare të Hetimit

Institucioni dhe adresa

Këshilli i Lartë i Prokurorisë Tiranë Rruga

**Data e dorëzimit të
deklaratës**

16.11.2017

Në bazë të nenit 9/1 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar,

A u t o r i z o j:

Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe personat e autorizuar nga Autoriteti Përgjegjës - Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, që të verifikojnë në të gjitha subjektet private e publike, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare, që ekzistojnë në emër dhe për llogarinë time.

Deklaroj se të dhënat e pasqyruara prej meje në këtë dokument janë të vërteta dhe nuk kam deklaruar asgjë që nuk është e vërtetë.

Nënshkrimi i subjektit deklarues

Altin Pano

**TË DHËNA PERSONALE TË
SUBJEKTIT DHE
PERSONAVE TË LIDHUR**

PËRBËRJA FAMILJARE E SUBJEKTIT SIPAS ÇERTIFIKATËS SË GJENDJES CIVILE

Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Nr.Personal	Lidhja me deklaruesin	Gjendja Civile
ALTIN	JANI	PANO	14.3.1968	F40422317M	DEKLARUESI	Martuar
BLERTA	AGIM	TUJANI	10.5.1971	M50433521K	BASHKESHORTJA	Martuar
GENTI	ALTIN	PANO	7.10.2001	N63423445R	I BIRI	BEQAR

Adresa e plotë ku jeni të regjistruar në Gjendjen Civile:

(Njësia Administrative Nr., Rruga, Pallati nr., Bashki/Komunë)

Rruga e Dibrës Pallati 27 Shk 3 Ap. 14

Nëse dispononi vendqëndrim tjetër,
adresa e plotë ku banoni:

Nuk disponoj

Rrethi i personave të lidhur me subjektin deklarues, në funksion të kufizimit të interesave private për konfliktin rast pas rasti dhe të vazhdueshëm janë: bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët në moshë madhore (brenda ose jashtë trungut familjar) dhe prindërit e subjektit e të bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es.

Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Nr.Personal	Lidhja me deklaruesin	Gjendja Civile
JANI	GJERGJI	PANO	10.2.1943	B23476512M	Babai i deklaruesit	MARTUAR
ZANA	TRIFON	PANO	14.3.1950	C43276852K	Nëna e deklaruesit	MARTUAR
AGIM	SAMI	TUJANI	7.6.1945	B82345769P	Babai i bashkëshortit/es bashkëjetuesit/es	MARTUAR
LINDA	BESNIK	TUJANI	17.6.1952	D26543987K	Nëna e bashkëshortit/es bashkëjetuesit/es	MARTUAR
SARA	ALTIN	PANO	11.9.1998	M37179823N	e bija e ndarë nga prindërit	MARTUAR
					Bashkëjetuesi/ Bashkëjetuesja	

Bashkëlidhur subjekti deklarues duhet të dorëzojë:

- Fotokopje të letërnjoftimit (kartës së identitetit) për vete, bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore.
- Fotokopje të pasaportës ose të çertifikatës personale për fëmijët e tjerë.

Të dhënat në këtë faqe janë konfidenciale.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i subjektit deklarues

Altin Pano

**DEKLARIMI I PASURIVE
DHE
BURIMI I KRIJIMIT**

Objekti i deklaramit: Të gjitha pasuritë e akumuluarra ndër vite deri në datën e dorëzimit të deklaratës së interesave private, sipas gërmës a, b, c, ç, d * të nenit 4 dhe nenit 4/1 të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” i ndryshuar, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil, të ndodhura brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të zotëruara nga kandidati për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë, apo në bashkëpronësi të tij me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe/ose me persona të tjerë.

Përshkruani hollësisht: llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhen, vitin e krijimit, vlerën në lekë apo në valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, çmimin e blerjes, në mungesë të dokumenteve shumë të shpenzimeve që keni kryer, pjesën takuese që zotëroni dhe burimet e krijimit të çdo lloj pasurie të regjistruar ose jo në regjistrat publikë.

Nr.	Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit	Vlera me shifra dhe me fjalë	Pjesa në %
1	Apartament banimi me sip. 217 m2 Rruga e Dibrës P.27 Shk 3 Ap 14 Tiranë, blerë më 7.3.2014 Burimi i krijimit: a) Kredi BKT shuma 120,000 Euro b) Kursime 2009-2014 nga të ardhurat familjare 20,000 Euro c) Huamarrje një personi fizik 30.000 Euro	170,000 Euro (njëqindshatëdhjetëmijë)	100
2	Autoveturë tip Ford Kugan me targa AA 910 KL viti prodhimit 2009. Blerë më 17.9.2013 Burimi i krijimit: Kursime nga të ardhurat familjare, 2007-2013	15,000 Euro (Pesëmbëdhjetëmijë)	100
3	Aksione në Delta Sha blerë më 19.1.2010 Burimi i krijimit: Nga shitje trualli, trashëguar nga prindërit	2,000,000 lekë (dymilion)	25%
4	Bono thesari në Bankën e Shqipërisë, krijuar më 7.5.2009 Burimi i krijimit: Të ardhura nga emigracioni në Itali në periudhën 2001 -2005	1,400,000 lekë (njëmilione katërqindmijë)	100

* **Neni 4, gërma a, b, c, ç, d i Ligjit nr.9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar:**

- pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil;
- pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publikë dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil;
- sendet me vlerë të veçantë mbi **300 000 lekë**;
- vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim;
- vlerën e likuiditeteve, gjendje në **Cash** jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj.

* **Neni 4/1.** Subjekti (kandidati) që plotëson këtë deklaram nuk mund të mbajë dhe të deklarojë gjendje në Cash, jashtë sistemit bankar, mbi shumën 1.5 (një presje pesë) milion lekë. Depozitimi në institucionet bankare i gjendjeve Cash mbi vlerën 1.5 (një presje pesë) milion lekë është i detyrueshëm përpara dorëzimit të deklaratës së interesave private në ILDKPKI.

Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në kopje të tij.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i subjektit deklarames

Altin Pano

**ANGAZHIME DHE VEPRIMTARI
PRIVATE DHE/OSE PUBLIKE
DHE TË ARDHURAT E KRIJUARA PREJ TYRE**

Objekti i deklaramit: Angazhime në veprimtari private dhe/ose publike me qëllim fitimi dhe çdo lloj veprimtarie e kryer brenda dhe jashtë vendit që ka krijuar të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, liçensa dhe patenta që sjellin fitim, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe pjesëmarrje në çdo organizatë tjetër; të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë, të bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es dhe fëmijëve në moshë madhore, për periudhën deri në datën e dorëzimit të deklaratës së interesave private.

Përshkruani hollësisht të ardhurat e krijuara nga çdo lloj angazhimi dhe veprimtarie të përshkruar më lart, emërtimi i institucionit, i organizatës apo i aktivitetit nga ku janë siguruar të ardhurat, adresa, nr. i regjistrimit publik, statusi, objekti i veprimtarisë së organizatës, funksioni dhe/ose natyra e angazhimit, deri në datën e dorëzimit të deklaratës të interesave private.

Përshkrimi i të ardhurave	Shuma e të ardhurave <u>neto</u> të krijuara, në lekë apo në valutë (me shifra dhe me fjalë)
1. Të ardhura nga puna Dekan në Fakultetin Juridik në Universitetin AB për periudhën 2009 deri 16.11.2017	4,300,000 lekë (katërmilionetreqindmijë)
2. Të ardhura nga tërheqja e dividendit nga Delta Sha për periudhën 2012 deri 16.11.2017	1,000,000 lekë (njëmilion)
3. Të ardhura nga Bono Thesari në Bankën e Shqipërisë për periudhën 2009 deri 16.11.2017	300,000 lekë (treqindmijë)
4. Të ardhura nga puna në emigracion në Itali 2001-2005	45,000 Euro (dyzetepesëmijë)

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i subjektit

Altin Pano

Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në kopje të tij.

**DETYRIMET FINANCIARE
NDAJ PERSONAVE JURIDIKË DHE FIZIKË**

Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë (kredi, huamarrje, detyrim ndaj të tretëve etj.) që ekzistojnë brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të mbetura ende pa u shlyer deri në datën e dorëzimit të deklaratës së interesave private nga kandidati për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë.

Të dhënat për emra personash ndaj të cilëve kandidati ka detyrime financiare, të pasqyrohen në faqen nr. 6, për të ruajtur konfidencialitetin e tyre

Përshkruani hollësisht qëllimin e detyrimit financiar, shumën totale në lekë apo në valutë, datën e fillimit dhe të mbarimit të detyrimit (muaji/viti), nr.e kontratës dhe interesin bazë, për kreditë bankare shumën e kredisë (principalin), kohëzgjatjen (muajin/vitin) dhe këstin mujor.

Përshkrimi i detyrimeve	Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer, deri në datën e dorëzimit të deklaratës së interesave private (me shifra dhe me fjalë)
1. Kredi bankare në BKT, dispursuar më 7.3.2014 në shumën 130.000 Euro, me afat 25 vjet me këst mujor 500 Euro. Gjendje më 16.11.2017 shuma 120.000 Euro	120,000 Euro (njëqindedyzetëmijë)
2. Huamarrje një personi fizik më 7.3.2014 shumën 30,000 Euro për blerje apartament banimi.	30,000 Euro (tridhjetmijë)

Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në kopje të tij.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi subjektiv

Altin Pano

TË DHËNA KONFIDENCIALE

<p>Të dhëna konfidenciale në lidhje me; pasuri private të paluajtshme dhe/ose të luajtshme, të regjistruara ose jo në regjistrat publikë, detyrime financiare, burimet e origjinës së pasurive, identitetin e personit juridik ose fizik, huadhënës a huamarrës, emërtesën e institucionit publik ose privat me të cilët keni marrëdhënie interesi.</p>	<p>Nr. i regjistrat publik, Nr. i kontratës noteriale, data/muaji/viti</p>
<p>1. Apartament banimi sipërfaqe 217 m2 Rruga e Dibrës , në proces hipotekimi. <i>Në dy dhoma jeton Genti Agim Tujani vëllai i bashkëshortes nga viti 2016</i> 2. Huamarrje z.Armand Besnik Delta në shumën 30,000 Euro me, 3. Kontratë kredie bankare me BKT me afat 25 vjet.</p>	<p>Kontratë Rep 2189 Kol 874 datë 7.3.2014 Kontratë, Rep 7271 Kol 3789 datë 7.3.2014 Kontratë Rep 2190 Kol 877 datë 7.3.2014</p>
<p>4. Autoveturë tip Ford Kugan me targa AA 910 KL viti prodhimit 2009.</p>	<p>Kontratë blerje Rep 7297 Kol 1225 datë 17.9.2013</p>
<p>5. Aksione në Delta Sha</p>	<p>Delta Sha me nr. NIPT.. Blerë me kontratë 5789 Rep, 1678 Kol datë 19.1.2010</p>
<p>6. Bono thesari në Bankën e Shqipërisë krijuar më 7.5.2009 dhe maturuar çdo vit në shumën 1.400.000 lekë. Maturimi i fundit më 10.5.2017</p>	<p>Bono Thesari B.SH. Nr 3789 datë 10.5.2017</p>

Të dhënat për personat fizikë e juridikë, duke përfshirë edhe personin e besuar që rezultojnë të lidhur me subjektin që mbart detyrimin për deklaram:

Emër, Atësi, Mbiemër i personit fizik dhe /ose emërtimi i personit juridik	Lidhja me deklaruesin	Lloji i interesave private, vendndodhja e tyre.
DELTA Sha	aksionier	Rr. Qemal Stafa Pallati 9 Tiranë

Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në kopje të tij.

**Emri, Mbiemri,
Nënshkrimi i subjektit**

Altin Pano

Telefon celular
0697071281

Telefon, faks, e-mail
042372780 ajani68@gmail.com



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE
DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE

Adresa: Rr.Reshit Çollaku, Tel: 0800 9999, Website: www.hidaa.gov.al, E-mail: info@hidaa.gov.al

DEKLARATË E PASURISË DHE
INTERESAVE PRIVATE E PERSONIT TË LIDHUR

Nr. Indeksi në ILDKPKI	
---------------------------	--

Plotësohet dhe nënshkruhet nga personi i lidhur me kandidatin (bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët në moshë madhore) që mbartin detyrimin për deklaram në bazë të nenit 22 të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, për pasuritë që disponohen veçmas.

A U T O R I Z I M
PËR KONTROLLIN E DEKLARATËS SË PASURISË DHE INTERESAVE PRIVATE

Në bazë të nenit 9/1, të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë ” i ndryshuar,

Autorizoj:

Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe personat e autorizuar nga Autoriteti Përgjegjës - Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, që të verifikojnë në të gjitha subjektet private e publike, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare, që ekzistojnë në emër dhe për llogarinë time.

Shtetasja Blerta Agim TUJANI,
Emër, Atësi, Mbiemër

bashkëshorti/ja	<input checked="" type="checkbox"/>
fëmijë madhorë së bashku me prindërit	<input type="checkbox"/>
fëmijë madhorë të ndarë nga prindërit	<input type="checkbox"/>
bashkëjetuesi/ja	<input type="checkbox"/>

e Subjektit Altin Jani PANO
Emër, Atësi, Mbiemër

Jam njohur me detyrimet që sanksionon legjislacioni në fuqi dhe deklaroj nën përgjegjësinë time ligjore se:

Disponoj pasuri veçmas të regjistruar në emrin tim

Nuk disponoj pasuri veçmas të regjistruar në emrin tim

Deklaroj se të dhënat e pasqyruara prej meje në këtë dokument janë të vërteta dhe nuk kam deklaruar asgjë që nuk është e vërtetë.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i personit të lidhur

Blerta Tujani

